



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ___/___/2019

Drejtuar: Z. Gramoz RUÇI, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Lënda: Depozitim Projektligji

I nderuar Z. Kryetar,

Bazuar në nenin 81 pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 68 të Rregulores së Kuvendit, Ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim në Kuvend Projektligjin “Disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i Ndryshuar”, nismë e një grupi deputetësh.

Ju faleminderit,

KRYETAR I GRUPIT PARLAMENTAR TË PSSH-së

Taulant BALLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Nr. _____/2019

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995,
“KODIPENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Neni 1

Në nenin 50 shtohet pika f/1, me këtë përmbajtje:

“f/1. Kur vepra është drejtuar ndaj personave të zgjedhur dhe funksionarëve publikë”.

Neni 2

Neni 96 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 96

Neglizhenca në trajtimin mjekësor

Neglizhenca në trajtimin mjekësor të të sëmurëve, nga ana e profesionistit shëndetësor ose personelit ndihmës, kur ka rrezikuar jetën e personit apo ka shkaktuar gjymtimin e tij të përhershëm, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neglizhenca në trajtimin mjekësor të të sëmurëve, nga ana e profesionistit shëndetësor ose personelit ndihmës, kur ka shkaktuar vdekjen e personit, dënohet me burgim deri në katër vjet.

Po kjo veprë, kur ka shkaktuar infektimin e të sëmurëve me infeksionin HIV/AIDS, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.”.

Neni 3

Pas nenit 149/b, shtohet neni 149/c, me këtë përmbajtje:

“Neni 149/c

Shkelja e të drejtave të autorit

Shpërndarja, komunikimi në publik, shitja, ofrimi për shitje, furnizimi, eksportimi ose importimi për qëllime të tërthorta apo të drejtëpërdrejta përfitimi, i veprës së mbrojtur nga e drejta e autorit pa pëlqimin e autorit ose e mbajtësit të së drejtës përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një here, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet”.

Neni 4

Neni 197 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 197 Organizimi i lojërave të palejuara

Organizimi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit, lotarive apo bixhozit, në kundërshtim me ligjin, dënohen me burgim nga një deri në tre vjet. Po kjo veprë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet, nëse në lojë marrin pjesë persona nën moshën 18 vjeç. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me një të katërtën.

Pjesëmarrja në lojërat e fatit që zhvillohen në kundërshtim me ligjin dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.”

Neni 5

Neni 201 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 201 Ndotja e ajrit dhe e tokës

Ndotja e ajrit, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes në përdorim të materialeve me rrezatim jonizues dhe radioaktiv apo e lëndëve të tjera toksike, e bërë tej kufirit të normave të lejuara me ligj, dënohen me burgim deri në tre vjet. Po kjo veprë, kur është kryer në zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar dëme të pakthyeshme të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur vepra penale e parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni:

- ka shkaktuar plagosjen e lehtë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.
- ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një ose disa personave, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet.
- ka shkaktuar vdekjen e një ose disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”

Neni 6

Pas nenit 201, shtohet neni 201/a, 201/b, 201/c, 201/d, 201/e, me këtë përmbajtje:

“Neni 201/a
Shkaktimi i fatkeqësive mjedisore

Prishja e pakthyeshme e ekuilibrit natyror të një ekosistemi, prishja e ekuilibrit të një ekosistemi për riparimin e dëmeve të të cilit kërkohet ndërhyrje në vlera të konsiderueshme financiare dhe marrja e masave specifike nga shteti, prishja e ekuilibrit të një ekosistemi që ka sjellë pasoja të rënda për shëndetin e një mase të konsiderueshme të popullsisë, dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër është kryer në zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, dënimi i dhënë shtohet me një të tretën.

Neni 201/b
Menaxhimi i mbetjeve

Grumbullimi, transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbetjeve, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës, kur shkakton dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur shkakton dëmtim të rëndë në shëndetin apo vdekjen e njeriut dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Neni 201/c
Transportimi i mbetjeve

Transportimi i mbetjeve që hyjnë, dalin apo tranzitohen nga territori i Shqipërisë, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 201/d
Aktivitetet e rrezikshme

Funksionimi i një impianti ku zhvillohet aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca apo preparate të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkaktojë dëme të rënda jashtë implantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në tetë vjet.

Po kjo vepër, kur shkakton dëmtim të rëndë në shëndetin apo vdekjen e njeriut dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Neni 201/e
Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme

Prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të

rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Po kjo vepër kur shkakton dëmtim të rëndë në shëndetin apo vdekjen e njeriut dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë vjet deri në njëzet vjet.

Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.”

Neni 7

Neni 202 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 202

Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër

Vrasja, shkatërimi, zotërimi, marrja ose tregtimi i egzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nën-produkteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre egzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve, dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në shtatë vjet.”

Neni 8

Pas nenit 202, shtohet neni 202/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 202/a

Habitatet në zonat e mbrojtura

Cdo vepër që shkel kërkesat e legjislacionit përkatës apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkakton përkeqësim të rëndë të një habitati që ndodhet brenda një zone të mbrojtur dënohet me gjobë ose me burgim nga dy deri në pesë vjet.”

Neni 9

Neni 203 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 203

Substancat ozon-holluese

Prodhimi, importimi, eksportimi, nxjerrja në treg ose përdorimi i substancave ozon-holluese duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose me burgim nga tre deri në shtatë vjet.”

Neni 10

Pas nenit 207, shtohet neni 207/1, me këtë përmbajtje

“Neni 207/1

Shkelja e rregullave të mbajtjes së kafshës së shoqërimit

Shkelja e rregullave për mbajtjen dhe shoqërimin e kafshës, mbajtja pa kujdesin e duhur të kafshës së shoqërimit, mosvendosja e maskës mbrojtëse qenve agresivë, nxitja me qëllim egërsimin e kafshëve që paraqet rrezik për njerëzit, në mjedise publike apo të hapura për publikun, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga tridhjetë mijë deri në njëqind mijë lekë.

Kur nga vepra penale ka ardhur plagosja e lehtë e një personi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj.

Kur nga vepra penale ka ardhur plagosja e rëndë e një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur nga vepra penale ka ardhur vdekja e një personi, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.”

Neni 11

Neni 237 ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 237

Goditjet për shkak të detyrës

Goditjet ose vepra të tjera dhune ndaj punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore apo të shërbimit publik, dënohen me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj personit të zgjedhur apo funksionarit publik, për shkak të veprimtarisë së tij, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj punonjësit të policisë për shkak të veprimtarisë së tij dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj profesionistit shëndetësor për shkak të veprimtarisë së tij dhe kur cilësitë e personit janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër kryhet në mjediset e institucionit ku personi ushtron detyrën shtetërore, funksionin publik apo shërbimin publik, dënohet me burgim nga tre deri në pesë vjet.”

Neni 12

Neni 238 ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 238

Kanosja për shkak të detyrës

Kanosja serioze për vrasje apo për plagosje të rëndë, që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit, dënohet me burgim deri në dy vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj personit të zgjedhur apo funksionarit publik, për shkak të veprimtarisë së tij, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Kur kjo vepër kryhet ndaj punonjësit të policisë për shkak të veprimtarisë së tij, kur cilësitë e personit janë të njohura ose të dukshme, dënohet me burgim nga dy deri në katër vjet.
Kur kjo vepër kryhet ndaj profesionistit shëndetësor për shkak të veprimtarisë së tij, kur cilësitë e personit janë të njohura ose të dukshme, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.”.

Neni 13

Pas nenit 238 shtohet neni 238/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 238/a Pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor

Pengimi me çdo mënyrë i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor, në mjediset e institucionit të kujdesit shëndetësor, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë.”.

Neni 14

Në nenin 274 “Prishja e qetësisë publike” pas paragrafit të parë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Ushtrimi i veprimtarisë ekonomike që lëshon/gjeneron zhurmë në mjedis, në kundërshtim me ligjin apo në tejkalim të normave të lejuara me ligj, kur është marrë më parë masa administrative, dënohet me gjobë nga njëqind mijë deri në një milion lekë, ose me burgim deri në dy vjet”.

Neni 15

Pas nenit 274, shtohen nenet 274/a dhe 274/b, me këtë përmbajtje:

“Neni 274/a Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv

Goditja ose vepra të tjera dhune ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në mjediset sportive, më shumë se një herë, apo është kryer nga drejtues apo anëtarë të klubeve sportive, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Neni 274/b

Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive

Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarreve, flakadanëve, gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Hyrja në fushën e lojës, gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv, nga persona të paautorizuar ose pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në aktivitetet sportive ndërkombëtare, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.”.

Neni 16

Në nenin 278, paragrafi i parë, ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“Mbajtja e armëve, e armëve shpërthyesë ose e lëndëve plasëse në automjete apo në çdo mjet tjetër të motorizuar, në mjedise publike ose në mjedise të hapura për publikun, pa lejen e organeve kompetente shtetërore, dënohet me burgim nga pesë deri në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.”.

Neni 17

Pas nenit 278/a, shtohet neni 278/b, me këtë përmbajtje:

“Neni 278/b

Prodhimi, mbajtja, tregtimi i armëve bërthamore, nukleare ose kimike.

Prodhimi, mbajtja, tregtimi i armëve bërthamore, nukleare ose kimike të dëmtimit në masë të popullsisë, dënohet nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet burgim”.

Neni 18

Në nenin 282, bëhen këto ndryshime:

Titulli i nenit ndryshon në: “Shkelja e rregullave mbi lëndët plasëse dhe djegëse”.

Fjalët “ose substanca radioaktive” në paragrafin e parë shfuqizohen.

Shenja e pikësimit “presje” pas fjalës “lëndë plasëse” në paragrafin e parë ndryshohet në “ose”.

Neni 19

Në nenin 282/a, bëhen këto ndryshime:

Titulli i nenit ndryshon si vijon: “Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse dhe helmuese”.

Fjalët “dhe substanca radioaktive” në paragrafin e parë shfuqizohen.

Shenja e pikësimit “presje” pas fjalës “i djegshëm” në paragrafin e parë ndryshohet në “ose”.

Neni 20

Neni 288, ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 288

Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin

Importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, pijeve, lëndëve të tjera ushqimore, barnave të rrezikshme si dhe futja në prodhim e kimikateve, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë e të pijeve, në shkelje të kërkesave të legjislacionit të posaçëm dënohet me burgim deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur është kryer në bashkëpunim, më shumë se një herë, ose kur nga kjo vepër penale është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit ose vdekja e njeriut, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e disa personave, fëmijëve, grave shtatzëna dënohet me burgim nga dhjetë vjet deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 21

Pas nenit 288/b, shtohet neni 288/c, 288/d, dhe 288/e me këtë përmbajtje:

“Neni 288/c

Importimi, prodhimi dhe tregtimi i ushqimeve, pijeve, barnave dhe artikujve të tjerë ushqimorë jashtë afatit të përdorimit

Importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, pijeve, barnave, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë e të pijeve pas afatit të përdorimit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjër në dy vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 288/d

Mashtrimi me produktet ushqimore

Importimi, prodhimi, ruajtja, ofrimi për shitje, falsifikimi, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, pijeve, barnave, materialeve dhe lëndëve shtesë në prodhimin e përpunimin e artikujve ushqimorë e të pijeve, në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk i korrespondojnë përmbajtjes, llojit, kategorizimit, prejardhjes, origjinës, sasisë apo cilësisë së produktit apo produkte pa të dhënat e mësipërme, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, ose paraqitja e të dhënave të rreme në etiketimin e produkteve ushqimore apo barnave, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda për shëndetin e njeriut, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Neni 288/e

Thyerja, heqja, zëvendësimi i shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore

Thyerja, heqja, zëvendësimi, ndërrimi ose falsifikimi i shenjave të sigurisë të vendosura nga organet shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore për qëllime mbikqyrjeje ose kontrolli ose pezullimi të veprimtarisë tregtare në mjediset ekonomike, mbi mjetet e transportit ose mbi mallra, me qëllim zhvleftësimin e masave të marra, lëvizjen e mallrave ushqimore ose rifillimin e aktivitetit, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet për mallra të kontaminuara ose të pidentifikuara, dënohet me burgim deri në pesë vjet.”

Neni 22

Neni 293 ndryshohet, si më poshtë vijon:

**“Neni 293
Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit**

Vënia e pengesave ose ndalimi, me çdo mjet e mënyrë, i qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujqor e ajror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.”.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, "KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

I. NEVOJA PËR AMENDIMET E KODIT PENAL DHE QËLLIMET E PROJEKTLIGJIT

Projektligji adreson disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal në fushat e mëposhtme:

- i. Mbrojtja nga dhuna e profesionistit shëndetësor;
- ii. Mbrojtja nga dhuna e policit, funksionarit publik, të zgjedhurit dhe personelit të shërbimit publik;
- iii. Rendi dhe qetësia publike/ndalimi i zhurmave;
- iv. Mbrojtja nga dhuna në sport;
- v. Mbrojtja e e të drejtës së autorit;
- vi. Ndalimi i veprimtarisë së lojrave të fatit;
- vii. Dekriminalizimi i gabimit mjekësor në rastet kur pasoja nuk vjen si rezultat i neglizhencës së mjekut;
- viii. Përdorimi i armëve dhe lëndëve plasëse pa leje të organeve shtetërore;
- ix. Mbrojtja nga kafshët shoqëruese në publik;
- x. Mbrojtja e mjedisit;
- xi. Siguria ushqimore.

Domosdoshmëria për amendimet në Kodin Penal për disa çështje, si prishja e qetësisë dhe rendit (goditja e policit), dhuna në shëndetësi, dhuna në aktivitete sportive, dhuna ndaj funksionarëve publike apo të zgjedhurve ka lindur referuar ngjarjeve të muajve të fundit ku incidentet e dhunës kundër mjekëve, ato në ndeshjet sportive, goditja ndaj policit apo veprat e dhunës kundër deputetëve e të zgjedhurve të tjerë kanë qënë të shpeshta. Parashikimet aktuale në Kodin Penal, rezulton se nuk garantojnë parandalimin për veprimet e dhunës. Dispozitat përkatëse në Kodin Penal për dënimin e këtyre fenomeneve ose kanë mangësi, ose sanksionojnë dënime të lehta ose nuk ekzistojnë. Me qëllim dënimin e cdo veprimi dhune dhe parandalimin e dhunës në shoqëri, propozohet ashpërsimi i dënimeve për veprat e dhunës ndaj policit, mjekut, sportistit, arbitrit, ndërmjetësit dhe trajnerit, funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve, apo atyre që shërbejnë në shërbimin publik si dhe përfshirja e veprave të reja penale për adresimin e duhur të çështjeve të dhunës si akte që ngarkojnë me përgjegjësi penale.

Nevoja për ndryshime në Kodin Penal mbi çështjet për mbrojtjen e të drejtës së autorit vjen si pasojë e debatit të gjerë publik për rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë kundër kopjimeve apo përdorimeve të padrejta të veprave të të tjerëve. Në Kodin Penal ka disa parashikime për mbrojtjen e pronësisë intelektuale apo riprodhimin e padrejtë të veprës së tjetrit, por dispozitat nuk janë të

plota sa i takon mbrojtjes së të drejtës së autorit, dhe dënime të përkatëse nuk i përgjigjen realitetit me qëllim parandalimin e këtyre fenomeneve shqetësuese për shoqërinë.

Ndryshimet që propozohen për ashpërsimin e dënimeve në veprimtarinë e lojrave të fatit janë pasojë e legjislacionit të ri në vend për ndalimin e veprimtarisë së lojrave të fatit dhe bixhozit.

Amendimet në lidhje me rendin dhe qetësinë publike janë pasojë e ankesave në rritje të qytetarëve anembanë vendit, që subjektet tregtare nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit për zhurmat dhe synojnë ashpërsimin e dënimeve në rastet kur ka tejkalim të normave të lejuara me ligj për zhurmat në mjedise që prishin qetësinë publike.

Projektligji propozon dhe dekriminalizimin e gabimit mjekësor në rastet kur pasoja nuk vjen si rezultat i neglizhencës së mjekut. Këto ndryshime synojnë të përmirësojnë klimën në të cilën profesionistët e shëndetit kryejnë detyrën e tyre dhe përmbushin misionin e tyre. Dispozita ekzistuese e Kodit Penal gjatë zbatimit të praktikës gjyqësore ka sjellë gjithmonë e në rritje vështirësi për profesionistët e shëndetit të kryejnë detyrat tyre. Kjo ka sjellë edhe zhvillimin e praktikave të ashtuquajtura të “mjekësisë difensive”. Megjithatë, për rastet kur dëmet e ndjeshme mbi shëndetin e pacientit vijnë si rezultat i mashtrimeve apo veprimeve të paligjshme, propozohen ndëshkime në raport të drejtë me dëmin e shkaktuar.

Projektligji propozon ashpërsim të dënimeve për mbajtjen e armëve, armëve shpërthyes ose e lëndëve plasëse në kundërshtim me parashikimet ligjore apo pa leje të organeve kompetente si dhe të veprimeve që synojnë pengesat apo ndalimin me çdo mjet e mënyrë, të qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik, hekurudhor, ujor e ajror. Këto ndryshime kanë si qëllim frenimin e përdorimit të armëve apo lëndëve plasëse si dhe parandalimin e veprimeve që pengojnë qarkullimin e transportit në kundërshtim me parashikimet ligjore. Nje amendim për ndalimin e prodhimit, mbajtjes dhe përdorimit të armëve bërthamore propozohet me qëllim përmbushjen e detyrimeve të vendit nga marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e sigurisë.

Ndryshimet që propozon projektligji në fushën e mbrotjes së mjedisit kanë për qëllim të transpozojnë plotësisht Direktivën 2008/99/EC për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal, *(Raporti i Progresit për vitin 2016 thekson faktin se Direktiva për Krimin në Mjedis nuk është transpozuar ende)*.

Projektligji përcakton dhe veprat penale të kryera nga persona fizikë a juridikë, me dashje apo nga pakujdesia dhe të cilat bien ndesh me legjislacionin specifik për mjedisin dhe për rrezatimet jonizuese apo me lejet/autorizimet që janë miratuar në zbatim të tyre dhe që rrezikojnë të shkaktojnë ose shkaktojnë dëm real mbi cilësinë e ajrit, ujit, tokës, bimët, kafshët, shëndetin apo jetën e njeriut. Legjislacioni në fushën e mjedisit dhe të rrezatimeve jonizuese ka avancuar mjaft kohët e fundit, duke transpozuar në legjislacionin tematik/administrativ të vendit pjesë të rëndësishme të Acquis së BE për mjedisin, të miratuar në përputhje me Traktatin e KE-së dhe aktet për rrezatimet jonizuese të miratuara në përputhje me Traktatin e Euratomit. Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për Kodin Penal. Ky i fundit, për veprat penale në fushën e mjedisit, mbetet ende thjesht me parashikimet kombëtare. Problematika e deri sotme në zbatimin dhe detyrimin e legjislacionit për mjedisin ka treguar se mjedisi nuk mund të mbrohet sic duhet vetëm përmes legjislacionit specifik/administrativ. Prandaj ky legjislacion duhet të plotësohet edhe me veprat

penale në fushën e mjedisit dhe sanksionet përkatëse të parashikuara në Kodin Penal. Për të siguruar një vazhdimësi dhe konsistencë midis kërkesave ligjore të legjislacionit specifik/sectorial për mjedisin dhe rrezatimet jonizuese të përafuara tashmë me ato të BE-së me parashikimet e Kodit Penal, kërkohet që edhe ky i fundit të reflektojë kërkesat e legjislacionit Evropian në fushën e mjedisit. Si pasojë e miratimit dhe zbatimit të këtyre amendimeve synohet dhe pritet që të rritet shumë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit i të gjithë aktorëve që veprojnë mbi mjedisin dhe që kanë potencial për ta rrezikuar atë përmes aktiviteteve të tyre.

Gjithashtu, projektligji adreson dhe disa ndryshime të rëndësishme që lidhen me sigurinë ushqimore, si një nga çështjet më aktuale, më delikate e njëkohësisht më sensitive në ditët e sotme. Projektligji propozon rishikimin e dispozitave ekzistuese që lidhen me sigurinë ushqimore dhe krijimin e figurave të reja të veprave penale, duke kriminalizuar fenomene/sjellje të cilat aktualisht, janë kategorizuar si forma të kundër-vajtjeve administrative, apo nuk kanë asnjë parashikim të mirëfilltë ligjor si shkelje - të cilat nuk duhet të përfshihen në këtë kategorizim administrativ, pasi për shkak të rëndësisë së marrëdhënieve juridike që synojnë të mbrojnë, natyrshëm duhet të klasifikohen si krime apo kundërvajtje penale.

Këto ndryshime kanë rëndësi tejet të lartë në funksion të garantimit të sigurisë ushqimore që është një komponent i sigurisë kombëtare, e lidhur ngushtësisht dhe me impakt të drejtpërdrejtë në shëndetin dhe jetën e popullsisë, ku mekanizmat mbrojtës duhet të bëhen efektivë në mbrojtje të interesave të konsumatorëve, si hallka më e pambrojtur e zinxhirit ushqimor.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PROJEKTLIGJIT

1. Në nenin 50 të Kodit Penal është shtuar si rrethanë rënduese në përcaktimin e dënimit për veprën penale, situata kur vepra drejtohet ndaj personave të zgjedhur dhe funksionarëve publikë.
2. Neni 96 i Kodit Penal riformulohet duke synuar dekriminalizimin e gabimit mjekësor. Neglizhenca në trajtimin mjekësor të të sëmurëve, si veprim apo mosveprim në kundërshtim me standartet profesionale në mjekësi së bashku me pasojat që vijnë nga kjo neglizhencë do të jenë përcaktuese për përgjegjësinë penale të mjekut. Sanksioni varion nga gjobë deri në shtatë vjet heqje lirie.
3. Shtohet neni 149/c që propozon rastet e kundërvajtjes penale për shkeljen e të drejtave të autorit dhe dënimin me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Në rastin e përsëritjes apo kryerjes së veprës në bashkëpunim dispozita parashikon ashpërsim dënimi.
4. Neni 197 riformulohet si pasojë e legjislacionit të ri për ndalimin e bixhozit dhe të lojrave të fatit. Organizimi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit, lotarive apo bixhozit, në kundërshtim me ligjin, dënohen me burgim nga një deri në tre vjet. Dënimi rëndohet nëse në këto veprimtari marrin pjesë persona nën 18 vjeç ose nëse veprimtaritë organizohen nga persona të veshur me pushtet ose kryejnë funksione publike.
5. Parashikimet e neneve nga 201 deri në 203 ndryshohen duke transpozuar Direktivën 2008/99/EC për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal. Konkretisht, Neni 201

riformulohet dhe pas tij shtohen dhe 5 dispozita të reja për të ashpërsuar dënimet e krimeve mjedisore si ndotja e ajrit dhe e tokës, shkaktimi i fatkeqësive mjedisore, keqmenaxhimi i mbetjeve, transportimi i mbetjeve në kundërshtim me ligjin, zhvillimi i aktiviteteve të rrezikshme, veprimtaritë në kundërshtim me ligjin në lidhje materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme. Rethana rënduese në caktimin e dënimit parashikohen në rastet kur shkaktohet dëmtim i rëndë në shëndetin apo vdekja e njeriut.

6. Neni 202 riformulohet duke synuar mbrojtjen e habitateve në zonat e mbrojtura, ndërsa neni 203 riformulohet me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga përdorimi i substancave ozon-holluese.
7. Pas nenit 207, shtohet neni 207/1 që parashikon sanksionet për shkeljen e rregullave të mbajtjes së kafshës së shoqërimit. Dënimi ashpërsohet në rastin e pasojave të rënda nga shkelja e këtyre rregullave, sic është plagosja apo vdekja e personit.
8. Neni 237 “Goditjet për shkak të detyrës”, riformulohet; Ashpërsohen dënimet për goditjet dhe veprat e dhunës kundër punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, si dhe ndaj personit të zgjedhur apo funksionarit publik, që parashikohet në Kod për herë të parë si vepër penale. Dënime më të ashpra parashikohen për goditjet ndaj policit dhe profesionistit shëndetësor, si dhe kur vepra penale kryhet në mjediset e institucionit shtetëror apo në vendin ku jepet shërbimi publik, (spital, klinikë etj). Në të njëjtën frymë me parashikimet e nenit 237, është riformuluar dhe neni 238 “Kanosja për shkak të detyrës”.
9. Pengimi i ushtrimit të detyrës së profesionistit shëndetësor prezantohet si kundërvajtje e re penale dhe për këtë qëllim shtohet një dispozitë e re pas nenit 238 të K.Penal.
10. Paragrafi i parë i nenit 274 “Prishja e qetësisë publike” riformulohet duke parashikuar dënimin për ushtrimin i veprimtarisë ekonomike që lëshon/gjeneron zhurmë në mjedis, në kundërshtim me ligjin apo në tejkalim të normave të lejuara me ligj.
11. Shtohen dy dispozita të reja pas nenit 274, që adresojnë veprimet e dhunshme në aktivitetin sportiv si goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv apo hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarreve, flakadanëve, gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv. Ashpërsim dënimi parashikohet në rastet kur vepra kryhet më shumë se një herë apo kryhet nga drejtues ose anëtarë të klubeve sportive.
12. Neni 278 riformulohet duke ashpërsuar dënimet për mbajtjen apo përdorimin e armëve, armëve shpërthyese ose e lëndëve plasëse pa lejen e organeve kompetente shtetërore. Në rast të përsëritjes apo pasojave të rënda dënimi maksimal i aplikueshëm është pesëmbëdhjetë vjet. Është shtuar një dispozitë e re, neni 278/b, që synon ndalimin e ptodhimit, mbajtjes, tregtimit të armëve bërthamore, nukleare ose kimike të dëmtimit në masë të popullsisë.

13. Neni 288 është riformular dhe tre dispozita të reja shtohen pas këtij neni që synojnë ndalimin e prodhimit dhe shitjes së ushqimeve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin, ndalimin e importimit, prodhimit dhe tregtimit të ushqimeve, pijeve, barnave dhe artikujve të tjerë ushqimorë jashtë afatit të përdorimit, dënimin e mashtrimit me produktet ushqimore si dhe ndalimin e thyerjes, heqjes, zëvendësimit e shenjave të sigurisë së organeve shtetërore në fushën e sigurisë ushqimore. Dënime më të ashpra parashikohen në rastet e bashkëpunimit për kryerjen e veprës penale, përsëritjes, rastet kur shkaktohet dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit ose vdekja e njeriut, vdekja e fëmijëve apo grave shtatzana.

III. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTLIGJIT

Projektligji është iniciativë e grupit parlamentar të Partisë Socialiste dhe materializim i vullnetit të mazhorancës qeverisëse për realizimin efektiv të të drejtave dhe lirive të shtetasve në disa fusha. Projektligji u hartua nga disa deputetë të Komisionit për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në bashkëpunim me ekspertët ligjorë të Kryeministrit dhe Ministrinë e linjës sipas çështjeve që adresojnë ndryshimet e propozuara.

Në hartimin e dispozitave të projektaktit që lidhen me sigurinë ushqimore, u mor në konsideratë materiali i grupit të punës së përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, Agjencisë Kombëtare të Ushqimit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe ekspertët Euralius (Tetor 2018), depozituar pranë Komisionit për Cështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në kuadër të nismës për rishikimin e Kodit Penal për mbrojtjen e kafshëve. Ndhimesë në hartimin e këtij projektligji dhanë ekspertët e Kryeministrit. Ministria e Mjedisit dhe Turizmit kontribuoi për hartimin e ndryshimeve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Ndryshimet në lidhje me dekriminalizimin e mjekimit të pakujdesshëm dhe mbrojtjen e mjekëve u hartuan në konsultim me Komisionin e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Drejtësisë. Ndryshimet mbi dënimin e veprave të dhunës ndaj policit, atyre që punojnë në shërbim publik, funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve, u hartuan në konsultim me Ministrinë e Rendit dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Referencë në hartimin e projektligjit u bë në legjislacionin italian sa i takon dekriminalizimit të mjekimit të pakujdesshëm, kuadrit ligjor në disa vende të Bashkimit Europian dhe rezolutave të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, akteve të UEFA dhe FIFA sa i takon dhunës në sporte, direktivat e zbatueshme në Bashkimin Europian sa i takon mbrojtjes së mjedisit, si dhe legjislacionin e Kosovës, Italisë, Greqisë, Polonisë, Francës, dhe Kalifornisë në fushën e sigurisë ushqimore.

DEPUTETËT

1. Jaulant Balla


2. ULSI MANJA


3. Blerina Gjylaku


4. Klotilde Buzeko

5. Durrus Gjurm


6. ERVIN BUDHATI



7. Basilius Fius  2019

8. Klodione Sjeker 

9. Ermomela Valkey 

10. Alket Hyseni  2019

11. Adhur Grometi  2019

Ishqiptaria.com